



# СЛУЖБЕНИ ГЛАСНИК ОПШТИНЕ БУЈАНОВАЦ

## GAZETA ZYRTARE E KOMUNËS SË BUJANOCIT

- VITI VI. - NUMËR 3.	- BUJANOC 26.02.2018 E hënë 26.02.2018	Botohet sipas nevojës – Çmimi 500 din.
--------------------------	--	---

### AKTET E KOMUNËS

#### PRESHEVË

#### Aktet e Kuvendit komunës

14

II.

36. 1.  
( „ . „ .129/07,  
83/2014- ) , . 35.  
„ . . „ .26/08) .  
9. , .011-  
2/2012 .

o  
Ky këshill votues ka zbatuar verifikimin e mandatit të këshilltarëve.

III.

19.02.2018 . :

Në mbështetje të nenit 36 al.1 të Ligjit mbi vetadministrimin lokal („Fl. zyrtare e RS“, nr. 129/07, 83/2014 - dhe ligji tjetër), nenit 35 të Statutit të komunës Preshevë („G: zyrtare e Rrethit të Pčinjës“, nr. 26/08) dhe nenit 9 të Rregullores së punës së Kuvendit Preshevë, nr. 011-2/2012 në propozim të kryesuesit të KK Preshevë në seancën konstitutive të mbajtur më 19.02.2018 nxjerr këtë :

Ky këshill ka karakter të përkohshëm dhe mandati i tij pushon pas kryerjes së votimit.

IV.

„  
Konkluzioni hyn në fuqi me ditën e miratimit, ndërsa do të shpallet në „G.zyrtare të Komunës së Bujanocit“.

V.

#### KONKLUZION MBI ZGJEDHJEN E KËSHILLIT VERIFIKUES

I.

:  
Konkluzioni ti dërgohet: të emëruarve dhe arkivit.

Për anëtar të Këshillit votues janë zgjedhë këta këshilltar:

#### KUVENDI I KOMUNËS PRESHEVË

1. Almin Shaqiri
2. Rinor Krasniqi
3. Shpëtime Hasani

I. /nr. 119-23  
/Më 22.2.2018

/Kryesuesi,  
, . . – d. v.

15

26

(„ . . . . . 129/07,34/10

54 /11), 31

(„ . . . . . 129/07)

30

(„ . . . . .

„ . 26/08)

19.2.2018. .

Në mbështetje të nenit 26 të Ligjit mbi zgjedhjet lokale (“Fl.zyrtare e RS”, nr.129/07,34/10 vendimit të Gj Kdhe 54/11) , nenit 31 të Ligjit mbi vetëadministrimin lokal (“Gaz. Zyrtare e RS ”, nr. 129/07) dhe nenit 30 të Statutit të komunës Preshevë (“Gaz. Zyrtare e Rrethit të Pçinjës”, nr. 26/08) Kuvendi i komunës Preshevë, në seancën konstitutive të mbajtur më: 19.2.2018. nxjerr këtë :

### VENDIMIN

#### MBI VËRTETIMIN E MANDATIT TË KËSHILLTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS PRESHEVË

#### I

Vërtetohet mandati i këshilltarëve të Kuvendit të komunës Preshevë të zgjedhur për këshilltarë dhe ate:

SHQIPRIM ARIFI

NGA LISTA ALTERNATIVA PËR NDRYSHIM

1. Shqiprim Arifi
2. Armend Aliu
3. Fetanete Mehmedi
4. Fatlum Kadriu
5. Alban Fazliu
6. Mimoza Fazliu
7. Argjend Sherifi
8. Skender Selimi
9. Arzana Bajrami
10. Fidan Nuhiu
11. Kastriot Sulejmani
12. Drenushe Kurtishi
13. Almin Shaqiri
14. Amir Latifi
15. Almina Iljazi

–Dr. RAGMI MUSTAFA

NGA LISTA E PARTISË DEMOKRATIKE  
SHQIPTARE

16. Ragmi Mustafa

17. Ramiz Latifi

18. Hilja Jusufi

19. Pajtim Rexhepi

20. Ylber Veliji

21. Hafize Shaqiri

22. Agim Sabedini

23. Xhelal Arifi

24. Drita Ramizi Kamberi

25. Shpat Aliu

26. Sefedin Sadiku

–ARDITA SINANI

NGA LISTA E PARTISË PËR VEPRIM  
DEMOKRATIK

27. Ardita Sinani

28. Nadërr Sadiku

29. Ridvan Tahiri

30. Shëndrit Jahiu

31. Flutura Hyseni

32. Rinor Krasniqi

GG.

U

E

–SAMI

SALIHU

NGA LISTA E GRUPIT QYTETAR LËVIZJA PËR  
REFORMA NË PARTISË DEMOKRATIKE  
SHQIPTARE

33. Sami Salihu

34. Avni Nuhiu

35. Shpëtime Hasni

NGA LISTA ALSADAR VUÇIQ- PËR SËRBIN E  
BASHKUAR

36. Branko Trajkovi

37. Dr. Branislav Manasijevi

NGA LISTA UNIONI DEMOKRATIK I LUGINËS

38. Skender Destani

#### II

1

19.2.2018.

Mandati i këshilltarëve të shënuar në pikën 1 të këtij Vendimi dotë zgjatë katër vite, ndërsa fillon me ditën e vërtetimit të mandatit, gjegjësisht më 19.2.2018.

### III

Ky Vendim të shpallet në “Gaz.zyrtare të komunës së Bujanocit”.

I ./Nr.119-25  
/Më 26.02.2018  
/ Preshevë

Kryesuesi,  
/ . . – d. v.

### 16

36. 1.  
( „ . “ .129/07,  
83/2014- ) , . 35.  
„ . . „ .26/08) .  
17. ,  
.011-2/2012 .

19.2.2018. :

Në mbështetje të nenit 36 al.1 të Ligjit mbi vetadministrimin lokal („Fl.zyrtare e RS“,nr.129/07,83/2014- dhe ligji tjetër), nenit 35 të Statutit të komunës Preshevë („G:zyrtare e Rrethit të Pçinjës“,nr.26/08) dhe nenit 17 të Rregullores së punës së Kuvendit Preshevë,nr.011-2/2012 në propozim të kryesuesit të KK Preshevë në seancën konstitutive të mbajtur më 19.2.2018. nxjerr këtë :

### KONKLuzion

#### MBI ZGJEDHJEN E KËSHILLIT VOTUES PËR ZBATIMIN E ZGJEDHJEVE

#### I.

:  
Për anëtar të Këshillit votues janë zgjedhë këta këshilltar:

1. Almin Shaqiri
2. Shpëtime Hasani
3. Argjend Sherifi

#### II.

o e:

Ky këshill votues ka zbatuar zgjedhjen: e Kryetarit të Kuvendit dhe zëvendës Kryetarin e Kuvendit.

### III

Ky këshill ka karakter të përkohshëm dhe mandati i tij pushon pas kryerjes së votimit.

### IV.

“ . ”  
Konkluzioni hyn në fuqi me ditën e miratimit, ndërsa do të shpallet në „G.zyrtare të Komunës së Bujanocit“.

### V.

:  
Konkluzioni ti dërgohet: të emëruarve dhe arkivit.

### KUVENDI I KOMUNËS PRESHEVË

I. /nr. 119-22  
/Më 22.2.2018.

/Kryesuesi,  
/ . . – d. v.

### 17

36. 1.  
( „ . “ .129/07,  
83/2014- ) , . 35.  
„ . . „ .26/08) .  
39. , .011-2/2012

19.2.2018. :

Në mbështetje të nenit 36 parag. 1. të Ligjit mbi vetadministrimin lokal („Fl.zyrtare e RS“,nr.129/07,83/2014- dhe ligji tjetër), nenit 35 të Statutit të komunës Preshevë („G:zyrtare e Rrethit të Pçinjës“,nr.26/08) dhe nenit 39. të Rregullores së punës së Kuvendit,nr.011-2/2012 në propozim të Kryetarit të KK Preshevë në seancën e mbajtur më 19.2.2018. nxjerr këtë :

### KONKLuzion MBI ZGJEDHJEN E KËSHILLIT VOTUES PËR ZBATIMIN E ZGJEDHJEVE

#### I.

:  
Për anëtar të Këshillit votues janë zgjedhë këta këshilltar:

1. Almin Shaqiri
2. Shpëtime Hasani
3. Argjend Sherifi

## II.

o e:

I

VALID

KAMBERI . ,

24.12.2018

Ky këshill votues ka zbatuar zgjedhjen: e Kryetarin e komunës, zëvendës Kryetarin e komunës dhe Anëtarët e Këshillin komunal.

I verifikohet mandati këshilltarit VELID KAMBERI nga fsh. Bushtran, komuna e Preshevës, këshilltar i Kuvendit të komunës së Preshevës i cili është zgjedhur në zgjedhjet e mbajtura më 24.10.2018., nga lista zgjedhore APN.

## III

Ky këshill ka karakter të përkohshëm dhe mandati i tij pushon pas kryerjes së votimit.

II

## IV.

“.”  
Konkluzioni hyn në fuqi me ditën e miratimit, ndërsa do të shpallet në „Gz.zyrtare të Komunës së Bujanocit“.

do isteka mandata odbornika kome je pretao mandat.

Mandati i këshilltarit të posazgjedhur fillon me ditën e verifikimit të mandatit dhe zgjatë gjerë në përfundim të mandatit të këshilltarit të cilit i ka pushua mandati.

## V.

Konkluzioni ti dërgohet: të emëruarve dhe arkivit.

III

Udhëzim juridik:Kundër këtij Aktvendimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën administrative në Vrajë.

IV

## KUVENDI I KOMUNËS PRESHEVË

Aktvendimi hyn në fuqi ditën e miratimit.

### I. /nr. 119-21

/Më 22.2.2018.

/ Kryetari,

Sami Salihu, . . – d. v.

18

.48, 56

( . , „ .129/2007, 34/2010  
, 54/2011 . 32 . 1 . 20),

. 31. („ . . „  
129/2007, 83/14) . 7. . 5

(„ . . „  
„ . 19/2012),  
19.2.2018 .

Në mbështetje të nenit 48, 56 të Ligjit mbi zgjedhjet lokale (“Fl.zyrtare e RS”, nr. 129/2007, 34/2010 Vendimi GJK, 54/2011 lidhur me nenin 32 al.1 pika 20), nenit 31 të Ligjit mbi vetadministrimin lokal (“Fl.zyrtare e RS”, nr. 129/2007, 83/14) dhe nenit 7 al.5 të Rregullores së Kuvendit të komunës Preshevë (“Fl.zyrtare e Qytetit të Leskocit”, nr. 19/2012), Kuvendi i komunës Preshevë në seancën e mbajtur më 19.2.2018., nxjerr këtë

/ A K T V E N D I M

V

„ . . .  
Aktvendimi të shpallet në “Fl.zyrtare të Komunës së Bujanocit”.

## KUVENDI KOMUNAL PRESHEVË

### I. /nr. 119-27

/datë: 26.2.2018

-Preshevë

/ Kryetari,

Sami Salihu, . . – d. v.

19

.48, 56

( . , „ . 129/2007, 34/2010  
, 54/2011 . 32 . 1 . 20),

. 31. („ . . .  
„129/2007, 83/14) . 7. . 5

(„ . . „  
„ . 19/2012),  
19.2.2018 .

Në mbështetje të nenit 48, 56 të Ligjit mbi zgjedhjet lokale (“Fl. zyrtare e RS”, nr. 129/2007,

34/2010 Vendimi GJK, 54/2011 lidhur me nenin 32 al.1 pika 20), nenit 31 të Ligjit mbi vetadministrimin lokal (“Fl. zyrtare e RS”, nr. 129/2007, 83/14) dhe nenit 7 al.5 të Rregullores së Kuvendit të komunës Preshevë (“Fl. zyrtare e Qytetit të Leskocit”, nr. 19/2012), Kuvendi i komunës Preshevë në seancën e mbajtur më 19.2.2018., nxjerr këtë

### / A K T V E N D I M

I

REDŽEPI

24.12.2018 .,

I verifikohet mandati këshilltarit DRITON REXHEPI nga Presheva, këshilltar i Kuvendit të komunës Preshevë i cili është zgjedhur në zgjedhjet e mbajtura më 24.10.2018., nga lista zgjedhore APN.

II

do isteka mandata odbornika kome je prestao mandat.

Mandati i këshilltarit të posazgjedhur fillon me ditën e verifikimit të mandatit dhe zgjatë gjerë në përfundim të mandatit të këshilltarit të cilit i ka pushua mandati.

III

Udhëzim juridik:Kundër këtij Aktvendimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën administrative në Vrajë.

IV

Aktvendimi hyn në fuqi ditën e miratimit.

V

Aktvendimi të shpallet në “Fl.zyrtare të Komunës së Bujanocit”.

### KUVENDI KOMUNAL PRESHEVË

I. /nr. 119-26  
/datë: 26.2.2018  
-Preshevë

/Kryetari,  
Sami Salihu, . . – d. v.

20

32.

(,, . “, .129/07),

35

(,,

“ .26/08

.110-4 20.12.2013) ,

19.2.2018.

Në mbështetje të nenit 32. Ligjit mbi pushtetin lokal (“Gz. Zyrtare e RS”, nr.129/07), dhe nenit 35. të Statutit të komunës së Preshevës (“Gz. Zyrtare Rrethit të Pçijës”, nr.26/08 dhe vendimit mbi ndryshimin dhe plotësimin e Statutit nr.110-4 të datës 20.12.2013), Kuvendi komunal Preshevë në seancën e datës 19.2.2018 nxjerr këtë:

### V E N D I M I

#### MBI NDËRPRERJEN E KOMPETENCËS SË ORGANIT TË PËRKOHSHËM TË KOMUNËS PRESHEVË

I

**Konstatohet** se me zgjedhjen e organeve ekzekutive të Komunës Preshevë, ndërprehet kompetenca e Organit të Përkohshëm të Komunës Preshevë për kryerjen e punëve vijuese dhe të pashtyeshme nga kompetenca e Kuvendit dhe organeve ekzekutive të Komunës Preshevë.

II

**Konstatohet** që Kryetari i Organit të Përkohshëm i Komunës Preshevë Shqiprim Arifit dhe anëtarëve të Organit të përkohshëm: Armend Aliut, Branko Trajkoviçit, Ragmi Mustafës, Ardita Sinanit dhe sekretarit të Organit të përkohshëm Enver Aliut i pushon funksioni me konstituimin e Kuvendit të komunës Preshevë dhe zgjedhjen e organeve ekzekutive të Komunës Preshevë.

**III**

**II.**

e

1.

Njëkohësisht i pushon funksioni i anëtarëve të Trupit punues të Organit të përkohshëm të Komunës Preshevë.

5.

15

**IV**

Ky Vendim të shpallet në “Fl.zyrtare të Komunës së Bujanocit”.

**KUVENDI KOMUNAL PRESHEVË**

6.

01.br./nr.020-5

Dana: 22.2.2018

, Preshevë

**Predsednik/Kryetari,**  
**Sami Salihu, . . – d. v.**

1.  
2.  
3.

21

32 1. 1. 4.

(“ . ”, .

129/2007), 35 1. 1. 5.

(“ . “ 6.

.26/08 I . 110-4 20.12.2013 7.

) 19.02.2018 ., 8.

2.

7

**I.**

1.

: )

43.

2.

3.

48

4.

8.

1.

14

9.

, 3 ( )

10.

15

1/3

11.

16

12

17

13

( ),

18

III.

19

23

20

4 ( )

24

25

26.

27.

28.

21

29.

30.

22

1/3

31.



V.

32.

1.

36.

37.

( )

4

33.

38.

1/3

34.

39.

3

IV.

( )

35.

40.

3

41.

:

( )

2.

46.

47.

42.

48.

43.

4

( )

44.

3.

49.

45.

4 ( )

50.

11. 56.

2( )  
51. 57.

52. 58.

: « 1/3

V.  
1. 53. 2. 60

1/3

54. 61.

55.

62

65.

63.

1.

66.

3.

64.

2.

67.

1.

2.

3.

4.

5.

6.

7.

8.

9.

10.

1.

2.

3.

4.

5.

6.

68.

69.

70.

3.

76.

71.

72.

77.

\* “ ” “

73.

VII.

1.

78.

74.

79.

7.

75.

1.

1/3

1/3

80.

5.

86.

24. 3

3.

87.

81.

88.

89.

2.

82.

90.

83.

91.

84.

85.

92.

( )

3 ( )

93.

94.

10 15

\* \*

100.

101.

4.

95.

1/3

7.

96.

102.

103.

97.

104.

5.

98.

105.

1 ( )

6.

99.

113.

106.

114.

8.

107.

108.

115.



IX.

116.

117.

109.

118.

110.

VIII.

119.

111.

112.



120.

127.

X

128.

121.

XI.

122.

123.

129.

124.

130.

1.

131.

125.

132.

126.

133.

XIV.

139.

134.

XV.

140.

30

135.

2

2

2.

136.

10

XVI.

141

137.

142.

138.

143.

\*

\*

I. . 110 – 3  
.26.02.2018 .

**Sami Salihu, . . – d. v.**

## **21**

Në mbështetje të nenit 32 parag.1 pika 1 të Ligjit mbi vetëadministrimin lokal (“Fl.zyrtare e RS”, nr. 129/2007) dhe nenit 35 parag.1 pika 1 të Statutit të komunës së Preshevës (“Fl.zyrtare e Rrethit të Pçinjës” nr.26/08 dhe vendimit mbi plotësim ndryshimin e Statutit të komunës Preshevë I nr.110-4 të datës 20.12.2013) Kuvendi i komunës Preshevë, në seancën e mbajtur më 19.02.2018, miratoi këtë

## **R R E G U L L O R E TË KUVENDIT TË KOMUNËS PRESHEVË**

### **I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

#### **Neni 1.**

Me këtë Rregullore rregullohet konstituimi i Kuvendit të komunës Preshevë ( në tekstin vijues : Kuvendi ).

#### **Neni 2.**

Kuvendin e përfaqëson Kryetari i Kuvendit.

#### **Neni 3.**

Puna e Kuvendit është e pranishme për opinion.

Në rastet e parapara me Ligj, me Statut të komunës dhe me këtë Rregullore, e mbyllur për opinion.

#### **Neni 4.**

Në Kuvend në përdorim zyrtar është gjuha serbe dhe gjuha shqipe dhe shkrimi i tyre.

### **II. KONSTITUIMI I KUVENDIT**

#### **1. Seanca e parë, konstitutive**

##### **Neni 5.**

Seancën konstitutive e konvokon kryetari i Kuvendit të mëparshëm, në afat prej 15 ditësh nga dita e shpalljes së rezultateve të zgjedhjeve.

Seancën konstitutive e udhëheq këshilltari më i vjetër, i cili është i autorizuar edhe ta konvokon seancën konstitutive nëse në afatin ligjor nuk e bënë kryetari i Kuvendit nga Kuvendi i mëparshëm.

##### **Neni 6.**

Rendi i ditës për seancën e parë (konstitutive), sipas rregullave, përmban:

1. Raporti i Komisionit komunal zgjedhor,
2. Zgjedhja e Komisionit verifikues,
3. Zgjedhja e Komisionit verifikues dhe verifikimi i mandatit të këshilltarëve të posazgjedhur,
4. Dhënja e deklaratave solemne të këshilltarëve të posazgjedhur,

5. Miratimi i Rregullores së Kuvendit,
6. Zgjedhja e kryetarit të Kuvendit,
7. Zgjedhja e zëvendës kryetarit të Kuvendit,
8. Emërimi i sekretarit të Kuvendit,

### **2. Verifikimi i mandatit**

#### **Neni 7.**

Mandati i këshilltarëve fillon të rrjedhë me ditën e verifikimit të mandatit.

Mbi verifikimin e mandatit të këshilltarëve vendosë Kuvendi në seancën konstitutive.

Mbi verifikimin e mandatit të këshilltarëve në bazë të raportit të Komisionit verifikues, Kuvendi vendosë me vota publike.

Në votim mund të marrin pjesë kandidatët për këshilltarë të cilëve i'u është ndarë mandati në pajtim me nenin 43 të Ligjit mbi zgjedhjet lokale dhe të cilt posedojnë certifikatat e Komisionit komunal zgjedhor se janë të zgjedhur.

Kur Kuvendi pas konstituimit vendosë mbi verifikimin e mandatit të këshilltarëve të rinjë, në votim, pranë këshilltarëve mund të marrin pjesë edhe kandidatët të cilëve mandati iu është ndarë në pajtim me nenin 48 të Ligjit mbi zgjedhjet lokale dhe të cilët kanë certifikatë të Komisionit komunal zgjedhor që janë zgjedhur.

#### **Neni 8.**

Verifikimi i mandatit të këshilltarëve bëhet në bazë të certifikatave mbi zgjedhjen për këshilltarë dhe raportin e Komisionit komunal zgjedhor mbi zgjedhjet e mbajtura për këshilltarë.

Raportin e Komisionit komunal zgjedhor mbi zgjedhjet e mbajtura e paraqet kryetari i Komisionit.

#### **Neni 9.**

Në seancën konstitutive të Kuvendit formohet Këshilli, prej 3 (tre) antarësh, për arsye të vërtetimit të pëlqimit të certifikatave mbi zgjedhjen për këshilltarë dhe raportit të Komisionit komunal zgjedhor. Përbërjen e këshillit verifikues e propozon kryesuesi.

Këshilli verifikues është zgjedhur nëse për te kanë votuar shumica e këshilltarëve prezent.

#### **Neni 10.**

Këshillit verifikues i dorëzohen certifikatat mbi zgjedhjet e këshilltarëve dhe raportin e Komisionit komunal zgjedhor mbi zgjedhjet e mbajtura për këshilltarë.

Kuvendi ndërpreu rrjedhën e seancës dhe cakton afatin për paraqitjen e raportit të Këshillit verifikues.

#### **Neni 11.**

Këshilli verifikues në bazë të raportit të Komisionit komunal zgjedhor mbi zgjedhjet e mbajtura për këshilltarë dhe certifikatat mbi zgjedhjet për çdo këshilltarë vërteton se a janë shënimet nga

certifikata mbi zgjedhjet të çdo këshilltari të njejtë me shënime nga raporti i Komisionit komunal zgjedhor dhe se a është certifikata e dhënë nga organi i autorizuar dhe për atë i paraqet Kuvendit raportin me shkrim.

#### **Neni 12.**

Në bazë të raportit të Këshillit verifikues, Kuvendi vendosë mbi verifikimin e mandatit të këshilltarëve me shumicë votash nga këshilltarët prezent.

#### **Neni 13.**

Pas verifikimit të mandatit, këshilltarët të cilëve i është verifikuar mandati japin deklaratën solemne, me nënshkrimin e tekstit të deklaratës solemne, që ka këtë përmbajtje:

**“Betohe se në punën e Kuvendit të komunës Preshevë do t’i përmbahem rreptësisht Kushtetutës, Ligjit dhe Statutit të komunës Preshevë dhe me nderë dhe në mënyrë objektive të kryej detyrën e këshilltarit, duke udhëhequr me interesat e qytetarëve të komunës Preshevë”.**

### **III. ZGJEDHJA E KRYETARIT DHE ZËVENDËS KRYETARËVE DHE EMËRIMI I SEKRETARIT TË KUVENDIT**

#### **1. Kryetari i Kuvendit**

##### **Neni 14.**

Kuvendi i komunës ka kryetarin e Kuvendit.

Kryetari i Kuvendit organizon punën e Kuvendit, konvokon dhe i kryeson seancat e Kuvendit, realizon bashkëpunimin me kryetarin e Komunës dhe Këshillin komunal, kujdeset mbi punën në opinion, nënshkruan aktet të cilat Kuvendi i nxjerr dhe kryen punë të tjera të caktuara me Ligj, Statut të komunës dhe me këtë Rregullore.

##### **Neni 15.**

Kuvendi zgjedh kryetarin nga rrada e këshilltarëve.

Kandidatin për kryetar të Kuvendit mund t’a propozon më së paku 1/3 e këshilltarëve.

Këshilltari mund të merr pjesë në propozimin e vetëm një kandidati.

Propozimi i kandidatit për kryetar të Kuvendit i paraqitet kryesuesit me shkrim dhe përmbanë: emrin dhe mbiemrin e kandidatit, biografën e shkurtër, përkatësin politike, nënshkrimet e këshilltarëve dhe emrin e paraqitësit të propozimit.

##### **Neni 16.**

Kryesuesi i Kuvendit njofton këshilltarët me të gjitha propozimet e pranuar të kandidatëve për kryetar të Kuvendit.

Mbi kandidatët e propozuar hapet diskutimi.

Këshilltari mundet në seancë të paraqet mendimin mbi kandidatin e propozuar.

Lista e kandidatëve përpilohet sipas alfabetit të mbiemrit të kandidatit.

##### **Neni 17.**

Me votim për zgjedhjen e kryetarit udhëheq kryesuesi i Kuvendit dhe dy këshilltarë (më i vjetri dhe më i ri), të cilëve i ndihmon sekretari i Kuvendit nga përbërja e mëparshme.

Procedurën e votimit e zbaton Komisioni prej tre antarësh, të cilën në propozim të kryesuesit e zgjedh Kuvendi.

##### **Neni 18.**

Votimi bëhet me fletëvotime

Të gjitha fletëvotimet janë në madhësi, formë dhe ngjyrë të njëjtë.

Të gjitha fletëvotimet janë të vulosura me vulë të Kuvendit.

Në fletëvotim kandidatët shënohen me rradhitje të caktuar në listën e kandidatëve ndërsa para emrit të çdo kandidati vehtet numri rendor.

##### **Neni 19.**

Kryesuesi thirr këshilltarët sipas listës së këshilltarëve të zgjedhur, që t’i marrin fletëvotimet, gjë që evidentohet.

Votohet vetëm për një kandidat nga kandidatët emrat e të cilëve shënohen në fletëvotim, me rrethimin e numrit rendor para emrit të tij.

##### **Neni 20.**

Komisioni përfundon procedurën e votimit pas konstatimit se të gjithë këshilltarëve prezent i është mundur votimi.

Procedura e vërtetimit të rezultateve të votimit bëhet sipas rradhitjes:

- Vërtetohet numri i fletëvotimeve të hartuara,
- Vërtetohet numri i këshilltarëve që janë prezent në seancë,
- Vërtetohet numri i këshilltarëve që kanë pranuar fletëvotimet,
- Vërtetohet numri i fletëvotimeve të papërdorura, të cilat vulosen në kovertë të veçantë,
- Hapet kutija e votimit dhe vërtetohet numrimi i numrit të fletëvotimeve në kuti.

Nëse numri i fletëvotimeve të jetë më i madh se numri i këshilltarëve që kanë votuar, materiali i votimit anulohet dhe procedura e votimit përsëritet.

- Ndahen fletëvotimet e pavlefshme dhe vulosen në kovertë të veçantë dhe
- Me numrin e fletëvotimeve të flefshme vërtetohet numri i votave që ka marrë çdo njëri nga kandidatët, gjë që evidentohet në formularë të veçantë.

Me fletëvotim të pavlefshëm nënkuptohet fletëvotimi i cili nuk është plotësuar, fletëvotimi i cili është plotësuar ashtu që nuk mund të vërtetohet me

siguri për kend ka votuar këshilltari, si dhe fletëvotimi në të cilin janë rrethuar më shumë kandidatë.

#### **Neni 21.**

Pas kryerjes së punës Komisioni i paraqet raport Kuvendit që përmbanë: numrin e fletëvotimeve të hartuara, numrin e këshilltarëve që janë prezent në seancë, numrin e fletëvotimeve të përdorura, të papërdorura dhe të pavlefshme dhe numrin e votave të cilit i ka marrë çdo kandidat.

#### **Neni 22.**

Për kryetar të Kuvendit është zgjedhë kandidati i cili ka marrë shumicën e votave nga numri i tërsishëm i këshilltarëve.

Nëse janë propozuar më shumë kandidatë, ndërsa asnjëri nuk ka marrë shumicën e duhur, votimi përsëritet dhe ate në mes të dy kandidatëve të cilit kanë marrë numrin më të madh të votave.

Nëse as në rrethin e dytë kryetari nuk zgjidhet, përsëritet procedura e zgjedhjes.

#### **Neni 23.**

Kryetari i Kuvendit merr detyrën pas shpalljes së votimit dhe merr udhëheqjen e seancës.

#### **Neni 24.**

Kryetari i Kuvendit zgjedhet për kohë prej 4 (katër) vitesh.

Kryetari i Kuvendit mund të jetë në punë të përhershme në Komunë.

#### **Neni 25.**

Kryetari i Kuvendit mund të jetë i shkarkuar edhe para kalimit të kohës për të cilën është zgjedhur në mënyrë të njëjtë si që është zgjedhur.

Kryetarit të Kuvendit mund t'i pushojë mandati edhe me paraqitjen e dorëheqjes, dorëheqja konstatohet në seancën e parë të rradhës të Kuvendit.

Deri në zgjedhjen e kryetarit të ri të Kuvendit, me Kuvend kryeson zëvendës kryetari i Kuvendit.

### **2. Zëvendës kryetarët e Kuvendit**

#### **Neni 26.**

Zëvendës kryetarët e Kuvendit e zëvendësojnë kryetarin në mungesë të tij në rast të pengesës që kryetari të kryej detyrën ose në bazë të autorizimit të posaçëm.

Zëvendësit zëvendësojnë kryetarin në mungesë të tij gjatë pengesës që të kryej detyrën ose në bazë të autorizimit të posaçëm të tij.

#### **Neni 27.**

Zgjedhja dhe shkarkimi i zëvendës kryetarëve të Kuvendit bëhet në mënyrë të njëjtë dhe sipas procedurës së njëjtë si për kryetarin e Kuvendit.

#### **Neni 28.**

Zëvendës kryetarëve mund ti pushoj funksioni para kalimit të mandatit me dorëheqje apo me shkarkim.

#### **Neni 29.**

Zëvendës kryetarët paraqesin dorëheqjen me shkrim .

Për dorëheqje vendos Kuvendi me shumicë nga numri i tërsishëm i këshilltarëve.

#### **Neni 30.,**

Zëvendës kryetarët e Kuvendit mund të jenë të shkarkuar në propozim të kryetarit të Kuvendit ose më së paku 1/3 e këshilltarëve. Propozimi paraqitet me shkrim dhe duhet të jetë i arsyetuar.

### **3. Sekretari i Kuvendit**

#### **Neni 31.**

Kuvendi ka sekretarin i cili kujdeset mbi kryerjen e punëve profesionale dhe administrative lidhur me konvokimin dhe organizimin e seancave të Kuvendit dhe trupave të tij dhe udhëheq me punët administrative lidhur për punën e tyre.

#### **Neni 32.**

Sekretarin e Kuvendit e emëron Kuvendi për katër vite , e në propozim të kryetarit të Kuvendit , në pëlqim me kushtet që janë të caktuara me ligj.

Votimi për emërimin e sekretarit është publike.

Sekretari i Kuvendit është i emëruar nëse për propozim ka votuar shumica nga numri i këshilltarëve.

#### **Neni 33.**

Sekretarit të Kuvendit mund ti pushon funksioni edhe para kalimit të mandatit , me dorëheqje ose me shkarkim.

Propozimin për shkarkimin e sekretarit mund ta paraqet kryetari i Kuvendit ose më së paku 1/3 këshilltarve.

Propozimi paraqitet me shkrim dhe duhet të jetë i arsyetuar.

#### **Neni 34.**

Sekretari i Kuvendit mund të ketë zëvendësin i cili e zëvendëson në rast të mungesës së tij.

Zëvendës sekretari i Kuvendit të komunës emërohet dhe shkarkohet në mënyrë të njëjtë dhe me kushte të njëjta si sekretari.

### **IV. GRUPET E KËSHILLTARËVE**

#### **Neni 35.**

Në Kuvend formohen grupet e këshilltarëve. Grupin e këshilltarëve e përbëjnë këshilltarët që i takojn partisë së njëjetë politike,koalicionit, organizatës politike ose grupit të qytetarëve.

Grupi i këshilltarëve ka më së paku 3 këshilltar.

Grupi i këshilltarëve konstituohet ashtu që kryetarit të Kuvendit i dorëzohet lista e grupit që e ka nënshkruar çdo anëtar i tij. Në listë veçmas shënohet kryetari i grupit të këshilltarëve.

Këshilltari mund të jetë anëtar i vetëm një grupi të këshilltarëve.

Mbi ndryshimin e përbërjes së grupit të këshilltarëve kryetari i grupit, me shkrim në pëlqim të këshilltarëve, që e ndërron përkatësin e grupit, njohton kryetarin e Kuvendit, gjë që për ate e informon Kuvendin.

Grupin e këshilltarëve e prezenton kryetari i grupit.

## **V. ZGJEDHJA E KRYETARIT, ZËVENDËS KRYETARIT TË KOMUNËS DHE KËSHILLIT KOMUNAL**

### **I. Kryetari i komunës**

#### **Neni 36.**

Organi ekzekutiv i komunës janë kryetari i Komunës dhe i Këshillit komunal.

#### **Neni 37.**

Kryetarin e komunës e zgjedh Kuvendi i komunës nga rradha e këshilltarëve, në kohë prej 4. vitesh, me vota të mshefta, me shumicë votash nga numri i tërsishëm i këshilltarëve të Kuvendit të komunës.

#### **Neni 38.**

Kryetari i Kuvendit të komunës propozon kandidatin për kryetar të Komunës.

Propozimi paraqitet me shkrim dhe përmbanë: emrin dhe mbiemrin e kandidatit, biografën e shkurtër, përkatësin partiake.

Mbi kandidatin e propozuar hapet diskutimi.

Këshilltari mundet në seancë të paraqet mendimin për kandidatin e propozuar.

#### **Neni 39.**

Me votim për zgjedhjen e kryetarit të komunës udhëheq kryetari i Kuvendit.

Procedurën e votimit e zbaton Komisioni prej 3 (tre) anëtarësh të cilin në propozim të kryetarit të Kuvendit ose grupeve të këshilltarëve e zgjedh Kuvendi.

#### **Neni 40.**

Votimi bëhet me fletëvotime, me ngjyrë, madhësi dhe formë të njëjtë dhe të vulosura me vulë të Kuvendit.

Në fletëvotim para emrit të kandidatit vehet numri rendor. Votimi bëhet me rrethimin e numrit rendor para emrit të kandidatit.

Fletëvotimet e pavlefshme nënkuptohen: fletëvotimet e paplotësuara, fletëvotimi i plotësuar

ashtu që nuk mund të vërtetohet me siguri për kend ka votuar këshilltari, si dhe fletëvotimi ku janë rrethuar më tepër kandidat nga numri që zgjedhen.

Në vërtetimin e rezultateve të votimit mund të marrin pjesë shefat e grupeve të këshilltarëve. Në vendin e caktuar për votim duhet të sigurohet msheftësia e votimit.

#### **Neni 41.**

Komisioni kryen procedurën e votimit pas konstatimit se të gjithë këshilltarëve prezent i është mundësuar të votojnë, dhe fillon procedurën e vërtetimit të rezultateve të votimit me këtë rradhitje:

- vërtetohet numri i fletëvotimeve të hartuara,
- vërtetohet numri i këshilltarëve që janë prezent në seancë,
- vërtetohet numri i këshilltarëve që kanë pranuar fletëvotimet,
- vërtetohet numri i fletëvotimeve të papërdorura, të cilat do të vulosen në koverta, hapet kutija e votimit dhe me numrimin vërteton numrin e fletëvotimeve në kuti,
- vërteton numrin e fletëvotimeve të vlefshme,
- vërteton numrin e fletëvotimeve të pavlefshme, që ndahen dhe vulosen në kovertë të veçantë,
- vërtetohet numri i votave që ka marrë kandidati i propozuar.

#### **Neni 42.**

Pas kryerjes së punës kryetari i Komisionit i paraqet Kuvendit raportin që përmbanë: numrin e fletëvotimeve të hartuara, numrin e këshilltarëve që marrin pjesë në seancë, numrin e fletëvotimeve të përdorura, të papërdorura dhe të pavlefshme dhe numrin e votave që ka marrë kandidati.

#### **Neni 43.**

Për kryetar të komunës është zgjedhur kandidati i cili ka marrë shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i këshilltarëve të Kuvendit të komunës.

Mandati i kryetarit të komunës zgjatë 4. (katër) vite.

Kryetarit të komunës me zgjedhjen në këtë funksion i pushon mandati i këshilltarit në Kuvend.

Kryetari i komunës është në punë të përhershme në komunë.

#### **Neni 44.**

Nëse Kuvendi nuk miraton propozimin e kryetarit të Kuvendit për zgjedhjen e kryetarit të komunës, do të kërkohet prej kryetarit të Kuvendit të propozon kandidatin e ri për kryetar të komunës, për të cilën Kuvendi do të deklarohet në seancën e rradhës.

#### **Neni 45.**

Kryetari i komunës mund të shkarkohet para kalimit të kohës për të cilën është zgjedhur, në propozim të arsyetuar të më së paku 1/3 e këshilltarëve, në mënyrë të njejtë si që është zgjedhur.

Mbi propozimin për shkarkimin e kryetarit të komunës duhet të disksutohet dhe vendoset në afat prej 15 ditësh nga dita e paraqitjes së propozimit kryetarit të Kuvendit.

Nëse Kuvendi nuk e shkarkon kryetarin e komunës, këshilltarët të cilt kanë paraqitur propozimin për shkarkim nuk mundën përsëri të paraqesin shkarkimin e kryetarit të komunës, para kalimit të afatit prej 6. muajsh nga refuzimi i propozimit të mëparshëm.

### **2. Zëvendës kryetari i komunës**

#### **Neni 46.**

Kryetari i komunës ka zëvendësin i cili e zëvendëson në rast të mungesës dhe pengesës për kryerjen e detyrës së vetë.

#### **Neni 47.**

Kandidati për kryetar komune propozon kandidatin për zëvendës kryetar të komunës nga rradha e këshilltarëve, të cilin e zgjedh Kuvendi i komunës në mënyrë të njejtë si kryetarin e komunës.

Kuvendi kur vendos mbi zgjedhjen e kryetarit të komunës njëkohësisht vendos edhe për zgjedhjen e zëvendës kryetarit e komunës dhe anëtarëve të Këshillit komunal.

Zëvendës kryetarit të komunës me zgjedhjen në funksion i pushon mandati i këshilltarit në Kuvendin e komunës.

Zëvendës kryetari i komunës është në punë të përhershme në komunë.

#### **Neni 48.**

Me shkarkimin e kryetarit të komunës i pushon mandati i zëvendës kryetarit të komunës dhe Këshillit komunal.

Zëvendës kryetari i komunës mund të jetë i shkarkuar para kalimit të kohës për të cilën është zgjedhur në propozim të kryetarit të komunës ose më së paku 1/3 e këshilltarëve, në mënyrë të njejtë si që është zgjedhur.

Kryetari i komunës është i obliguar që Kuvendit të komunës njëkohësisht me propozimin për shkarkimin e zëvendës kryetarit të komunës i paraqet edhe propozimin për zgjedhjen e zëvendës kryetarit të ri të komunës dhe Kuvendi njëkohësisht bjen vendim mbi shkarkimin dhe mbi zgjedhjen.

### **3. Këshilli komunal**

#### **Neni 49.**

Këshilli komunal kryen punët e komunës në pajtim me Ligjin dhe Statutin e komunës.

Këshillin komunal e përbëjnë kryetari i komunës, zëvendës kryetari i komunës, si dhe anëtarët

e Këshillit komunal numri i të cilve është vërtetuar me Statut të komunës dhe të cilt i zgjedh Kuvendi i komunës në periudhën prej 4 (katër) vitesh, me vota të mshefta, me shumicë votash nga numri i tërsishëm.

#### **Neni 50.**

Kandidatët për anëtarë të Këshillit komunal i propozon kandidati për kryetar komune.

Kur vendoset mbi zgjedhjen e kryetarit të komunës, Kuvendi i komunës njëkohësisht vendosë mbi zgjedhjen e zëvendës kryetarit të komunës dhe anëtarëve të Këshillit komunal.

Kryetari i Komunës është kryetar i Këshillit komunal.

Zëvendës kryetari i komunës është anëtarë i Këshillit komunal sipas funksionit.

Numri i anëtarëve të Këshillit komunal, të cilt Kuvendi i komunës i zgjedh në propozim të kryetarit të komunës nuk mund të jetë më i madh se 11.

Anëtarët e Këshillit komunal të cilët i zgjedh Kuvendi i komunës nuk mundet njëkohësisht të jenë edhe këshilltarë.

Këshilltarit i cili të jetë zgjedhur për anëtarë të Këshillit komunal i pushon mandati i këshilltarit.

#### **Neni 51.**

Kandidati për kryetar komune paraqet listën e përbashkët të kandidatëve për anëtarë të Këshillit komunal.

Mbi kandidatët e propozuar hapet diskutimi.

Pas përfundimit të diskutimit, për propozimin për anëtarë të Këshillit komunal votohet me vota të mshefta.

#### **Neni 52.**

Pas zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit komunal japin betimin: **“Betohe se në punën e Këshillit komunal të komunës Preshevë do t'i përmbahem rreptësisht Ligjit dhe Statutit të komunës Preshevë dhe me nderë dhe në mënyrë objektive të kryej detyrën e anëtarit të Këshillit komunal, duke udhëhequr me interesat e qytetarëve të komunës Preshevë”**.

Teksti i nënshkruar i betimit anëtarët e Këshillit komunal i'a dorëzojmë Kuvendit të komunës.

### **V. TRUPAT PUNUESE TË KUVENDIT**

#### **1. Formimi dhe përbërja e trupave punues**

#### **Neni 53.**

Për shqyrtimin dhe diskutimin e çështjeve nga kompetenca e Kuvendit dhe kryerja e punëve tjera në pëlqim me këtë Rregullore formohen trupat e përhershëm , të përkohshëm dhe trupat punuese ankrete.

Trupat punues japin mendim në propozim dispozitat, vendimet dhe aktet tjera të cilat i nxjerr Kuvendi i komunës, kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me Statut të komunës.

Numri i trupave punues, zgjedhja, të drejtat dhe detyrat e kryetarit dhe anëtarëve të trupave punues përcaktohen me Statut të komunës dhe me Vendim të veçantë të Kuvendit të komunës.

#### **Neni 54.**

Anëtarët e trupave punues emërohen nga radha e këshilltarëve dhe qytetarëve.

Kryetari i trupit punues emërohet nga radha e këshilltarëve.

#### **Neni 55.**

Anëtarët e trupave të përhershëm punues emërohen për periudhën mandatore për të cilën Kuvendi është zgjedhur

Trupat punues të përkohshëm dhe ankete i formon Kuvendi për kryerjen e detyrave të posaçme dhe puna e tyre pushon pas kryerjes së detyrës për çka janë formua.

#### **Neni 56.**

Përbërjen e trupave punues e propozon kryetari i kuvendit në konsultim me kryetarët e grupeve të këshilltarëve.

Këshillatri mund të jetë anëtar i dy më së shumti trupave punues të Kuvendit.

#### **Neni 57.**

Për listën e propozuar për zgjedhjen e trupit punues, Kuvendi vendos në tërësi, me vota të hapura.

Trupi punues është formuar nëse për ate kanë votuar shumica e këshillatrëve prezent.

#### **Neni 58.**

Çdo anëtar i trupit punues mund të paraqet dorëheqje.

Kuvendi mund të shkarkon veçmas anëtarët e trupit punues para kalimit të kohës për të cilën janë emëruar.

Propozimin për shkarkim mund ta paraqes 1/3 e këshilltarëve.

Anëtari i trupit punues është shkarkuar nëse për ate ka votuar shumica e këshilltarëve prezent.

### **Trupat e përkohshëm punues**

#### **Neni 59**

Trupat e përkohshëm punues janë Komisionet, grupet punuese të këshilltarëve dhe trupat tjera të përkohshme punues të përcaktuara me Statut të komunës.

## **2. Mbledhjet e trupave punues**

#### **Neni 60.**

Mbledhjen e trupit punues e thirr kryetari i trupit punues sipas iniciativës së vetë ose në iniciativ të më së paku 1/3 anëtarve të grupit punues, ndërsa është i obliguar ta thirr mbledhjen nëse ate e kërkon kryetari i Kuvendit. Nëse edhe në atë rast kryetari i

trupit punues nuk e thirr mbledhjen, mbledhjen e thirr kryetari i Kuvendit.

Në rast të pengesës së kryetarit, mbledhjen e trupit punues e thirr kryetari i Kuvendit, ndërsa trupi punues e zgjedh kryesuesin për atë mbledhje.

#### **Neni 61.**

Trupi punues punon ku janë prezent shumica e anëtarëve të trupit punues, ndërsa vendos me shumicë votash të anëtarëve prezent të trupit punues.

Mbledhja e trupit punues thirret më së voni 3 ditë para mbajtjes së mbledhjes, ndërsa mund të thirret edhe në afat më të shkurtër nëse për ate ekzistojn arsyet.

#### **Neni 62.**

Në mbledhjen e trupit punues mund të prezentojnë dhe marrin pjesë në punë, pa të drejtë vendosjeje edhe këshilltari që nuk është anëtar i trupit punues.

Në punën e trupit punues mund të marrin pjesë edhe anëtarët e Këshillit komunal, m'varësisht nga çështja që është në rend dite.

Në punën e trupit punues mund pa ftesë të marrin pjesë edhe persona tjerë.

#### **Neni 63.**

Në kryerjen e punëve nga fushëveprimi i vetë, trupi punues mund nëpër mes kryetarit të vetë të kërkon nga administrata komunale shenimet dhe informatat me rëndësi për punën e vetë.

Pas kryerjes së diskutimit, trupat punues i paraqesin Kuvendit mendimet dhe propozimet e veta.

Trupi punues e cakton paraqitësin e vetë.

Në mbledhjen e trupit punues udhëhiqet procesverbal.

Në procesverbal shënohen veçmas: emrat e të pranishëmve, çështjet që janë shtjelluar, mendimet dhe propozimet e trupit punues, çdo mendim veçmas, si dhe paraqitësit që i ka caktuar trupi punues.

Procesverbalin e nënshkruan kryetari i trupit punues dhe personi që e ka udhëhequr procesverbalin.

## **3. Trupat e përhershëm punues**

#### **Neni 64.**

Trupat e përhershëm punues të Kuvendit janë: Pleqësitë dhe Komisionet.

#### **Pleqësitë e Kuvendit janë:**

1. Pleqësia për çështjet e vetadministrimit lokal,
2. Pleqësia për buxhet e financa,
3. Pleqësia për arsim, kulturë, informim dhe sport,
4. Pleqësia për shëndetsi, mbrojtje sociale dhe mbrojtja e fëmijëve,
5. Pleqësia për urbanizëm dhe veprimtari komunal-banesore,
6. Pleqësia për mbrojtjen e mjedisit jetësorë,
7. Pleqësia për ekonomi dhe komunikacion,
8. Pleqësia për bujqësi,



9. Pleqësia për marrëdhënje nacionale,
10. Pleqësia për të rinjtë

#### **Komisionet e Kuvendit janë:**

1. Komisioni për dispozita,
2. Komisioni për çështje mandatore të imunitet, administrative dhe zgjedhje dhe emërimet,
3. Komisioni për peticione dhe ankesa,
4. Komisioni për bashkëpunim me qytetet në vend dhe jashta vendit,
5. Komisioni për emërtimin e rrugëve, shesheve dhe vendbanimeve tjera në territorin e komunës.
6. Komisioni për barazi gjinore.

#### **Neni 65.**

Përbërja, kompetenca, mënyra e zgjedhjes dhe mënyra e punës së trupave të përhershëm punues , caktohen me aktin për formimin e tyre, që i miraton Kuvendi, në pëlqim me Statutin e komunave.

### **VI. MIRATIMI I AKTEVE TË KUVENDIT**

#### **1. Llojet e akteve**

##### **Neni 66.**

Kuvendi miraton Vendime, aktvendime, konkluzione, interpretime autentike dhe lloje tjera të akteve.

Me Vendim rregullohen çështjet nga lëmit e caktuara që janë në kompetenc të komunës.

Me konkluzion precizohen qëndrimet, gjegjësisht orientimet, mendimet, konstatimet, obligimet, autorizimet , me rastin e shqyrtimit të çështjeve të caktuara.

Me aktvendim emërohet , formohet, përcaktohet, vërtetohet, caktohet ndonjë lëndë kur vendoset për lëndë të veçanta dhe obligimet e subjektëve të veçantë.

Me interpretim autentik bëhet interpretimi i akteve ose i disa dispozitave të tyre të cilat Kuvendi i miraton.

#### **2. Procedura e miratimit të akteve**

##### **Neni 67.**

Propozimin e vendimit dhe aktit tjetër mund ta paraqet kryetari i komunës, këshilltari, Këshilli komunal dhe trupat e përhershëm punues të Kuvendit..

Propozimi paraqitet në atë formë si akti miratohet dhe duhet të jetë i arsyetuar. Arsyetimi përmban: bazën juridike dhe arsyet për nxjerrjen e aktit.

##### **Neni 68.**

Propozimi para se të shqyrtohet në Kuvend , do të shqyrtohet në trupat kompetente punuese.

Trupat kompetente punuese në mendimet e veta mund ti propozojn Kuvendit që të miratojn propozimin në tërësi ose të propozojn që Kuvendi të miraton vendimin ose aktin tjetër në tekstin e

ndryshuar pjesërisht ose në tërësi, varësisht nga teksti që e ka paraqitur propozuesi dhe propozimin mos ta pranon.

##### **Neni 69.**

Kuvendi mbi propozimin që është vuar në rend dite të seancës , vendos pas diskutimit , përveç në rastet në të cilat me këtë Rregullore është caktuar që të vendoset pa diskutim.

##### **Neni 70**

Pas kryerjes së diskutimit kalohet në votimin e propozimit.

Mbi propozimin votohet në tërësi. Nëse është paraqitur amendament, së pari vendoset për ate e pastaj mbi propozimin në tërësi.

##### **Neni 71.**

Propozuesi i akteve, gjegjësisht përfaqësuesi i saj mund në fillim të diskutimit të paraqet arsyetimin plotësues të propozimit. Ai ka të drejtë të merr pjesë në diskutim deri në përfundimin e diskutimit mbi propozimin, që të jap sqarime dhe paraqet mendimin e vetë.

##### **Neni 72.**

Propozimi për ndryshimin dhe plotësimin e propozimit dhe akteve tjera paraqitet me anë të amendamenteve .

Amendamenti paraqitet me shkrim me arsyetim , më së voni një ditë para mbajtjes së seancës, ndërsa kur seanca është konvokuar urgjent amendamenti mund të paraqitet në seancë.

Propozuesi i vendimeve dhe i akteve tjera mund të paraqet amendamente krejt deri në përfundimin e diskutimit të propozimit.

Mbi amendamentin gjithësesi deklarohet popozuesi.

##### **Neni 73.**

Kuvendi së pari vendos për amendamentet e paraqitura para mbajtjes së seancës.

Amendamentin që e paraqet propozuesi bëhet pjesë pëbërse e propozimit dhe për ate Kuvendi nuk deklarohet veçmas.

Nëse janë paraqitur më shumë amendamente në të njejtin nen të propozimit , më parë vendoset për amendamentin ku propozohet të shlyhet ai nen.

##### **Neni 74 .**

Aktet që i miraton Kuvendi , ndërsa për miratimin e të cilëve është paraparë me ligj pëlqimi i mëparshëm ose mendimi i Ministrisë kompetente , mund të miratohen në seancë pas marrjes së pëlqimit , gjegjësisht mendimit dhe në pëlqim me të njejtat.

##### **Neni 75 .**

Çdo propozues i autorizuar mund të paraqet propozimin që aktin për çështje të veçantë të

vendosjes me procedurë urgjente i obligueshëm është ta arsyetohet urgjencën për vendosje.

Mbi procedurën për nxjerrjen e aktit me procedurë urgjente Kuvendi vendosë pa diskutim. Para votimit Kuvendi njoftohet me arsyetimin e propozimit.

Nëse Kuvendi miraton propozimin që akti të bihet me procedurë urgjente, propozim akti vehet në rend dite.

Propozim akti i cili bihet me procedurë urgjente duhet t'i dërgohet këshilltarëve më së voni deri në fillimin e seancës.

### **3. Ruajtja dhe shpallja e akteve**

#### **Neni 76**

Në vendimin origjinal dhe aktet tjera të Kuvendit dhe në interpretimin origjinal autentik vehet vula e Kuvendit.

Me origjinalin e Vendimit gjegjësisht të aktit tjetër ose interpretimit autentik nënkuptohet teksti i Vendimit gjegjësisht akti tjetër ose interpretimi autentik i miratuar në seancën e Kuvendit.

Origjinali i Vendimit gjegjësisht aktit tjetër i Kuvendit dhe interpretimi autentik ruhet në Kuvend.

Mbi hartimin e origjinalit, vuarjen e vulës në to, ruajtjen dhe për evidentimin e tyre kujdeset sekretari i Kuvendit.

#### **Neni 77**

Aktet të cilat i miraton Kuvendi shpallen në “Fl.zyrtare të Rrethit të Pçinjës”, “Gazetën zyrtare të Qytetit të Vranjës” dhe “Gazetën zyrtare të komunës së Bujanocit”

Mbi shpalljen e vendimeve dhe akteve tjera të Kuvendit dhe interpretimit autentik kujdeset sekretari i Kuvendit.

Sekretari i Kuvendit në bazë të tekstit origjinal të Vendimit, aktit tjetër ose interpretimit autentik bën përmirësimet e gabimeve të tekstit të shpallur të vendimit dhe aktit tjetër ose të interpretimit autentik, nëse për të ka nevojë.

## **VII. SEANCA E KUVENDIT**

### **1. Konvokimi i seancës**

#### **Neni 78**

Seancën e Kuvendit e konvokon kryetari i Kuvendit sipas nevojës, e më së paku një herë në tre muaj.

Seancën e Kuvendit e konvokon kryetari i Kuvendit sipas iniciatës së vetë, në propozim të kryetarit të komunës, 1/3 e këshilltarëve ose Këshillit komunal.

#### **Neni 79**

Kryetari i Kuvendit është i obliguar që seancën ta konvokon në afat prej 7 ditësh kur ate me shkrim e kërkon propozuesi i autorizuar nga neni i mëparshëm.

Nëse kryetari i Kuvendit nuk e konvokon seancën si që është paraparë në al.1 të këtij neni, seancën mund ta konvokon kryetari i Komunës, Këshillit komunal ose 1/3 e këshilltarëve, me shkrim, me nënshkrim të kryetarit të komunës, gjegjësisht këshilltarit të parë të nënshkruar nga rradha e 1/3 e këshilltarëve që kërkojnë konvokimin e seancës.

#### **Neni 80**

Seancat e Kuvendit konvokohen me shkrim.

Ftesa për seancë duhet të përmbajë, vendin dhe kohën e mbajtjes së seancës.

Ftesën për seancë të Kuvendit i dërgohet këshilltarëve më së voni 5 ditë para ditës së caktuar për mbajtjen e seancës.

Këshilltarëve me ftesë i dërgohet edhe propozimi i rendit të ditës, materiali përkatës për çështjet që propozohen për rend dite, si dhe procesverbali nga seanca e mëparshme.

Kur ekzistojnë arsyet që duhet arsyetuar afatin nga al. 3 të këtij neni mund të jetë më i shkurtër por jo më i shkurtër se 24 orë.

Kur seanca mbahet sikurse që u cek në alinen e mëparshme të këtij neni, në vetë seancë mund të paraqiten amendamente me shkrim ose me gojë.

#### **Neni 81**

Për seancën e Kuvendit, përveç këshilltarëve, ftohen kryetari i komunës, anëtarët e Këshillit komunal, kryeshefi i administratës komunale dhe udhëheqësit e njëjësive themelore organizative të administratës komunale.

Siaps nevojës në seancë mund të ftohen edhe persona tjerë.

### **2. Hapja e seancës dhe rendi i ditës**

#### **Neni 82**

Kryetari hap seancën e Kuvendit, kur në bazë të evidencës zyrtare vërtetohet se janë prezent shumica e këshilltarëve. Nëse ndonjë këshilltar shpreh dyshimin në ekzistimin e kворumit për punë, bëhet thirrja e këshilltarëve.

#### **Neni 83**

Seancat e Kuvendit dhe trupave të tij punues janë publike.

Seancat e Kuvendit dhe të trupave të tij punues mund të jenë të mbyllura për opinion. Propozimin e arsyetuar e jep kryetari i Kuvendit. Për atë propozim votohet pa diskutim.

#### **Neni 84**

Rendin e ditës e propozon kryetari i Kuvendit, në bazë të propozimit dhe materialit të arritur si dhe raportit të sekretarit të Kuvendit.

Sekretari i Kuvendit kujdeset që të gjitha pyetjet e parapara për rend dite të jenë sa më mirë, që për ato të mundësohet hapja e diskutimit në seancë, si

dhe çështjet e caktuara të diskutohen sipas trupave përkatës punues të Kuvendit.

#### **Neni 85**

Në procedurë të caktimit të rendit të ditës veçmas vendoset mbi çdo propozim konkret, me propozimet e dhëna me rradhë.

Pyetjet e këshilltarëve dhe inicijativat janë pikat e veçanta të rendit të ditës.

Në rend dite hyjn edhe përgjigjet në pyetjet e këshilltarëve, ndërsa cila pikë e rendit të ditës do të jetë, caktohet para vërtetimit të rendit të ditës.

Rendi i ditës vërtetohet në tërësi me ndryshime dhe plotësime të pranuar në propozimet e veçanta.

#### **Neni 86**

Caktimi i rendit të ditës bëhet në fillim të seancës me shumicë votash të këshilltarëve prezent.

### **3. Puna në séance**

#### **Neni 87**

Para se të fillohet me rend dite miratohet procesverbali nga senca e mëparshme . Për vërejtjet në procesverbal Kuvendi vendos pa diskutim.

#### **Neni 88**

Njohtimet e duhura mbi punët e rëndësishme ndërmjet dy seancave , para se të kalohet në rend dite , me gojë i paraqet kryetari i Kuvendit.

Për këtë nuk hapet diskutimi.

#### **Neni 89**

Diskutimi lidhur me pikat e rendit të ditës bëhet sipas rradhitjes së caktuar.

Mbi shqyrtimin e pikave të caktuara pa radhitjen në rend dite vendos kryetari i Kuvendit

#### **Neni 90**

Para diskutimit të çdo pike , përfaqësuesi i propozuesit mund të jep fjalën hyrëse.Pas paraqitjes së fjalës hyrëse hapet diskutimi mbi çështjen konkrete.

#### **Neni 91**

Askush nuk mund të flas në seancën e Kuvendit para se të kërkon dhe ta merr fjalën nga kryetari.

Kryetari i Kuvendit ia jep fjalën këshilltarëve sipas rradhës së lajmërimit, gjer sa ka folës.Folësi i cili dëshiron ta merr fjalën për herë të dytë mund ta merr pasi të kryhet lista e folësve që flasin për herë të parë, edhe ate vetëm nëse kryesuesi vlerëson se pika e rendit të ditës nuk është shqyrtuar sa duhet.

Kryetarit të komunës, anëtarëve të Këshillit komunal përfaqësuesve të grupeve të këshilltarëve dhe sekretarit të Kuvendit i ipet fjala kur e kërkojn.

#### **Neni 92**

Folësi mund të flasë vetëm mbi çështjen që është në rend dite siaps rregullave jo më gjatë se 5 minuta.

Këshilltari ka të drejtë që të jep sqarime nëse në diskutimin e mëparshëm ceket në mënyrë direkte ose indirekte personaliteti i tij ose fjalët e tij janë interpretuar gabimisht.Në këtë rast kryetari i Kuvendit ia jep fjalën , gjë që nuk mund të flasë më shumë se 3 minuta.

#### **Neni 93**

Askush nuk mund ta ndërprej folësin , e as t'ia tërheq vërejtjen , përveç kryetarit të Kuvendit.

#### **Neni 94**

Seancat e Kuvendit zgjasin prej ora 10 deri në ora 15.

Kryetari mundet gjatë seancës ta ndërprej të njëjtën dhe të cakton ditën dhe orën e vazhdimit të saj.

Kryetari do ta ndërprej seancën kur e vërteton se nuk ka kворum, për shkak të nevojës që të kryhen përgaditjet e duhura dhe të mirren mendimet, si dhe në raste tjera dhe të caktohet termini i vazhdimit të saj.

### **4. Shkelja e Rregullores**

#### **Neni 95**

Çdo akt dhe lëndë që paraqet heqje dorë nga procedura në punën e Kuvendit paraqet shkeljen e Rregullores së Kuvendit.

#### **Neni 96**

Këshilltari i cili dëshiron të flasë mbi shkeljen e Rregullores, kryetari i Kuvendit ia jep fjalën kur e kërkon, gjegjësisht menjëher pas kryerjes së diskutimit të folësit të mëparshëm.

Këshilltari duhet të cek dispozitën e Rregullores që sipas mendimit të tij është shkelur.

Kryetari i Kuvendit ndërprej diskutimin mbi çështjen lëndore dhe jep sqarime mbi shkeljen e Rregullores . Nëse këshilltari nuk është i kënaqur me sqarimin e kryetarit të Kuvendit , mbi shkeljen e Rregullores vendos Kuvendi pa diskutim.

#### **Neni 97**

Kuvendi vendos mbi shkeljen eventuale të Rregullores me shumicë votash të këshilltarëve prezent.

### **5. E drejta për replikë**

#### **Neni 98**

Këshilltari ka të drejtë në replikë nëse në diskutimin e mëparshëm në mënyrë fyese është folur për te ose fjalët e tij gabimisht janë kuptuar apo interpretuar.

Kryetari i Kuvendit atij këshilltari menjëherë ia jep fjalën.

Këshilltari mundet më së shumti të flas 3 minuta vetëm për lëndën e replikës.

## **6. Vendosja në seancë**

### **Neni 99**

Kuvendi vendos me shumicë votash në seancën ku janë prezent shumica nga numri i tërësishëm i këshilltarëve .

Kur kjo është e vendosur me Statut të komunës , Kuvendi vednos për disa çështje me shumicë votash të numrit të tërësishëm të këshilltarëve.

### **Neni 100**

Këshilltari ka të drejtë dhe detyrë të voton për çdo propozim për të cilin vendoset.

Gjatë votimit kryetari fton këshilltarët që të deklarohen kush është “për “, pastaj kush është “kundër”propozimit dhe në fund se a ka të përmbajtur nga votimi.

### **Neni 101**

Pas kryerjes së votimit kryetari vëteton rezultatin e votimit , në bazë të të cilit shpallet se propozimi për të cilin është votuar a është miratuar apo jo.

Nëse më pak se 1/3 këshilltarëve shprehin dyshimin në rezultatin e paraqitur të votimit , fillohet me numrin e votave dhe ajo mund të bëhet vetëm njëherë për çështjen e njejtë.

## **7. Mbajtja e rendit në séance**

### **Neni 102**

Mbi rendin në seancën e Kuvendit kujdeset kryetari.

Për shkeljen e rendit në seancë kryetari mund të shqiptoj masën e tërheqjes së vërejtjes ose marrjen e fjalës.

